



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 17 Akti Nr. 28 Vendimi

Tiranë, më 25.06.2018

VENDIM

Trupa gjyquese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, e përbërë nga:

Genta Tafa (Bungo)	Kryesuese
Pamela Qirko	Relatore
Suela Zhegu	Anëtare

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore Olsida Goxhaj, pas shpërndarjes me short të çështjes dhe caktimit të kryetarit dhe relatorit, sot, më datë 25.06.2018, ora 11:00, në sallën nr. 2 të selisë së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit:

Znj. Brunilda KASMI- GJYQTARE PRANË GJYKATËS TË RRETHIT GJYQËSOR TIRANË

BAZA LIGJORE : Neni “G” i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
Nenet 14 dhe 57 të ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese.

RRETHANAT E ÇËSHTJES

Subjekti i rivlerësimit, Znj. Brunilda Kasmi, gjatë periudhës së fillimit të procesit të hetimit administrativ ka ushtruar detyrën e gjyqtares pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Për shkak të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”, i është nënshtruar procesit

të rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Në referim të nenit 276 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, subjekti i rivlerësimit, Znj. Brunilda Kasmi, duke qenë se ka kandiduar për anëtare e Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ), u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit me përparësi në kohë, duke u shortuar si subjekt rivlerësimi me shortin e hedhur më datë 30.11.2017 nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

Konstatohet se Znj. Brunilda Kasmi ka ushtruar detyrën e gjyqtares pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nga data 13.05.2000 deri më 30.04.2018, datë në të cilën ka dhënë dorëheqjen.

Me shkresën protokolluar pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, me nr. 1433 prot., datë 30.04.2018, me lëndë “Kërkesë dorëheqje”, Znj. Kasmi ka paraqitur dorëheqjen nga funksioni i gjyqtares pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në vijim, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, pasi mori në shqyrtim këtë kërkesë, vendosi të deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit, për shkak të dorëheqjes së gjyqtares Brunilda Kasmi, mbështetur në nenet 63,64 dhe 160, pika 1, germa “a”, të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Me kërkesën nr. 1136/1, datë 24.05.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, vendimin nr. 30, datë 07.05.2018, i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, u vu në dispozicion më datë 01.06.2018.

ARSYET E PËRFUNDIMIT TË PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

Neni “G” i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ka parashikuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të dhënë dorëheqjen:

“1. Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet.

2. Subjekti i rivlerësimit, që dorëhiqet sipas kësaj dispozite, nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare”.

Neni 56 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” ka parashikuar të drejtën e dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit si vijon:

“1. Subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të japë dorëheqjen nga detyra jo më vonë se 3 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Dorëheqja i paraqitet me shkrim Presidentit të

Republikës dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të këtij institucioni. Në rastin e dorëheqjes, Komisioni merr vendim për pushimin e procedurës së rivlerësimit.

2. Pas dhënies së dorëheqjes, subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të përfitojë pagesë kalimtare, sipas nenit 7, pika 1, të ligjit "Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit".

Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese, paragrafi 43, ka interpretuar, ndër të tjera, lidhjen ndërmjet këtyre dy dispozitave si vijon:

"[...] Neni 56 i ligjit i jep mundësinë subjektit që dorëhiqet brenda afatit 3-mujor, të përfitojë pagesë kalimtare sipas parashikimeve ligjore në fuqi, mundësi të cilën nuk e përfitojnë subjektet që e japin dorëheqjen pas përfundimit të këtij afati. Gjykata thekson se, për sa kohë që subjekti i rivlerësimit është në detyrë dhe procesi i rivlerësimit nuk ka përfunduar ende, ai ka të drejtën të japë dorëheqjen dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet, duke u zbatuar parashikimet e nenit G të Aneksit të Kushtetutës."

Me paraqitjen e kërkesës së subjektit të rivlerësimit, Komisioni është vënë në dijeni të dorëheqjes së subjektit Brunilda Kasmi "nga funksionet e magjistratit" dhe me vendimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë për mbarimin e këtij statusi.

Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit ka shfrytëzuar të drejtën që i njeh Kushtetuta për dorëheqje. Kjo sjell si pasojë përfundimin e kësaj procedure administrative dhe, si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit humbet të drejtën për t'u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare, sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE

Trupa gjyquese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenin G të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 57 të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë",

V E N D O S I:

1. Të deklarojë se procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Brunilda Kasmi, është ndërprerë.
2. Të deklarojë humbjen e së drejtës të subjektit të rivlerësimit për t'u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.

3. Ky vendim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit.
4. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apëlimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 25.06.2018.

ANËTARËT E TRUPËS GJYKUESE

GENTA Tafa (BUNGO)

Kryesuese

PAMELA QIRKO
Relatore

SUELA ZHEGU
Anëtare

OLSIDA GOXHAJ
Sekretare gjyqësore